



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr.286/1Prot.

Shkodër, më 21.01.2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Rruga: _____

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 735, datë 08. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 286, datë 08. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Shërbimet pranë qendrave komunitare “Për Familjen” ofrohen sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ligjit nr. Nr. 9669, date 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ndryshuar me Ligjin Nr. 10329, datë 30.09.2010, Ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Për çdo individ apo familje, përfitues/e e shërbimeve pranë qendrave komunitare “Për familjen”, bëhet vlerësimi sipas VKM-së nr. 578, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si edhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

Gjithashtu pas zbatimit disa vjeçar të modelit të qendrave komunitare, së fundmi janë aprovuar standartet e qendrave Multifunkionale Komunitare me Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “ Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore”.

Bashkangjitur ju dërgojmë rregulloren e qendrave komunitare “Për Familjen” dhe gjithashtu fact sheet për vitin 2017, mbi rezultatet e përgjithshme të ofrimit të shërbimeve sociale dhe komunitare. Ndërkohë, të dhënat e vitit 2018 janë në proces.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Voltana Ademi